

- Nga 16 ministri gjithsej, vetëm Ministria e Mbrojtjes ka të miratuar në Qeveri Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, nëntë ministri janë në fazë ose të hartimit të rregullores në grup punues ose e njëjta gjendet në fazën e konsultimeve publike derisa gjashtë ministri tjera nuk kanë kthyer përgjigje;
- Nga 46 agjenci ekzekutive gjithsej në kuadër të ministrive, asnjë nga to nuk e ka të miratuar në Qeveri Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Gjashtë agjenci nuk e kanë filluar këtë proces, 18 agjenci nuk kanë kthyer përgjigje derisa 21 agjenci tjera janë në fazën ose të hartimit të rregullores në grup punues ose e njëjta gjendet në fazën e konsultimeve publike. Instituti i Mjekësisë Ligjore si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e ka miratuar këtë rregullore mirëpo e njëjta është vetëm e nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë por jo edhe e miratuar në Qeveri;
- Agjencitë ekzekutive janë fare pak të njoftuara me përmbajtjen e ligjit, konkretisht për obligimin që agjencitë ekzekutive duhet të hartojnë rregullore për organizim të brendshëm ndaras nga ministritë (apo ministria amë) dhe se miratimi i tyre është po ashtu i ndarë, etj.